



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina**



E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Të mbledhjes së dytë të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara,
mbajtur më 05.04.2022, e cila filloi në orën 13:30.

Në mbledhje morën pjesë: Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, dhe anëtarët e komitetit:
Ramadan Salihu, Mehreme Llumnica, Jeton Canhasi, Gyltene Retkoceri dhe Ermira Shabani.

Mungoi Armend Ademi.

Në mbledhje ishte e pranishme edhe Premtime Preniqi, koordinatore për të drejtat e njeriut.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Fatime Demolli-Mustafa, me këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit Konsultativ të Personave me Aftësi të Kufizuara;
2. Ndarja e përgjegjësive mes anëtarëve të Komitetit për zbatim dhe monitorim të Planit të veprimit;
3. Të ndryshme.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, i përshëndeti dhe i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Ajo tha se në pikën "Të ndryshme", i përfshijmë subvencionimet në Drejtorinë e Sportit.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit Konsultativ të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Kryesuesja konstatai se u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit Konsultativ të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Pika e dytë

Ndarja e përgjegjësive mes anëtarëve të Komitetit për zbatim dhe monitorim të Planit të veprimit.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, për ndarjen e përgjegjësive mes anëtarëve të Komitetit për zbatim dhe monitorim të PV, propozoi të ndahen në grupe dhe nga dy anëtarë, duke i shoqëruar edhe unë si kryesuese e Komitetit, që t'i takojmë drejtorët e drejtorive që kanë të bëjnë me PV, dhe t'u bëjmë kërkesa, të caktojmë takime, të konsultohemi si po veprojmë më tutje. Në këtë mënyrë e kemi më lehtë për me monitoruar PV, po të njëjtën kohë e kemi më lehtë me bashkëpunuar me drejtorët sa i përket zbatimit të pikave që i kemi në PV. Ky është propozimi im, nëse pajtoheni ju anëtarët ose keni ide tjera se si duhet të veprohet, këtë rast me shikuar se a ka filluar të zbatohet.

Gyltene Retkoceri tha se anëtarët duhet të shkojnë jo vetëm në një drejtori, por në më shumë drejtori, sepse kemi shumë drejtori.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha se kemi më shumë drejtori sesa anëtarë të komitetit.

Gyltene Retkoceri theksoi se kjo po më pëlqen si ide, nga dy anëtarë me kryesuesen, por me qenë ne profesionistë të asaj fushe dhe me i marrë ato drejtori.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha se nuk do të thotë patjetër me qenë e profilit.

Premtime Preniqi u shpreh e pajtimit me mendimin e Gyltenes, se si pikë e parë me qenë edhe profesioni, mandej me i caktuar edhe ndonjë drejtori tjetër që mundet me mbështetur.

Ramadan Salihu u shpreh se është mirë që ka filluar monitorimi, d.m.th. muajin e kaluar e patëm iniciativën, tash veç po kalon në konkretizim, dhe kjo është për t'u përshtendetur. Modalitetet janë një tjetër gjë, por kornizën e monitorimit a e keni paraparë a do të jetë ajo që ka qenë, apo do ta hartojmë një tjetër kornizë. Janë edhe dy çështje tjera, e para është aspekti kohor, cilën fazë e përfshin ky monitorim, a do të shkojmë në baza vjetore apo gjatë gjithë vitit periudhës së paraparë sipas planit, i cili është deri më 2023, apo do të shkojmë muaj për muaj, në mënyrë periodike, dhe pastaj është tjetra, komiteti është shumë më operativ, shumë më praktik, por komiteti do të ishte mirë të shkojë unik, se është organ kolektiv, dhe të shkoni nëpër dikastere.

Premtime Preniqi tha se duke pasur parasysh se PV-ja është bërë në një vit kur ka qenë një qeverisje tjetër në pushtet, e tani ka filluar një qeverisja e re, nuk është me rëndësi a shkoni ju si grup apo shkoni 3 vetë, por me rëndësi është në takimet me shkuan me pikat kryesore të cilat i ka ajo drejtori. Pak e nxit edhe atë se ku janë, ndoshta nuk e kanë idenë as që ekzistonit një PV.

Mehreme Llumnica u shpreh se kam një informatë lidhur me monitorim. "Hendikos" në Prishtinë e ka marrë një projekt, duke u nisur prej asaj që është miratuar PV dhe me disa lëshime, pa u ftuar përfaqësuesit që kanë marrë pjesë, grupet punuese, sidomos shoqëritë civile të cilët kanë marrë iniciativa, ata e kanë synim me KCSF me revidu, me plotësuar për nevojat shtesë që i kanë personat, OJQ-të e nivelit lokal. Aty janë përfaqësuesit e grupeve punuese dhe ato rekomandime me i përcjellë, me i monitoruar në PV.

Premtime Preniqi dha sqarime, duke thënë se ky PV është i nivelit komunal.

Me sa kam informata, niveli komunal nuk ka nevojë me i pyetur hiq OJQ -të, tjetër është që bashkëpunon, mirëpo PV është i nivelit komunal. Është një vendim, në të cilin nuk thotë që me bashkëpunuar me OJQ-të asgjë, për shkak se të gjitha këto e përfaqësojnë një kategori - PAK. Ajo që po mendoni ju si OJQ, është shtesë e mirëseardhur për Komunën, por ato që i shtini ju shtesë si OJQ, ato mbèsin monitorim, me i monitoruar vet OJQ -ja po zbatohen apo nuk po zbatohen, e ne mundemi me bashkëpunuar mandej si komitet, por monitorimin e këtij PV duhet me bërë vet Komiteti.

Ramadan Salihu tha se ky PV nuk mund të ndryshohet deri më 2023.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha se unë po mendoj si OJQ me na ndihmuar në zbatim dhe monitorim të drejtive, me iu bërë presion drejtive.

Mehreme Llumnica ceku iniciativat e shoqërive civile. Ato janë direkt në kontakt me ta, se çdo ditë shkojnë për probleme dhe bashkëpunimi nëse monitorohet ose zbatohet, ose hyn në veprim apo identifikohen nevojat prej të dy palëve, ato janë të mirëseardhura.

Ramadan Salihu tha se këto janë të njëjtat pika, siç janë punësimi, pjerrinat, semaforët, nuk ka kush çka shton.

Mehreme Llumnica përmendi rastin me "Prishtina Parking", ku derisa është marrë iniciativë, ose i ke përmendur, askush nuk e ka ditur që duhet me u liruar. Po ashtu, ajo ceku edhe çështjen e taksize private.

Ramadan Salihu bëri të ditur se të gjitha janë në pikën 12 të PV-së, por pse nuk i realizojnë është diçka tjetër.

Mehreme Llumnica informoi se kryetari, Përparim Rama, ka thënë se parashihen 20 vende për PAK dhe do të bëhet ashtu siç është e paraparë me rregullore. Këtë e ka transmetuar në "Hendikos", ka kërkuar identifikim të kualifikimeve, me ia dërguar listat për të gjitha kategoritë e aftësive të kufizuara.

Premtime Preniqi theksoi se nëse e qet për 20 PAK, atëherë konkursi duhet me qenë vetëm për PAK.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, pyeti Mehremen se a mundeni ju, meqë jeni me KCSF, me na ndihmuar neve anëtarëve në monitorim të zbatimit të PV-së me ndonjë donacion.

Mehreme Llumnica dha sqarime.

Jeton Canhasi tha se në mbledhjen e kaluar nënkyetari dhe të pranishmit i shprehen mendimet e tyre se do t'i bëjmë këto e ato, por biseda e përfaqësueses së Drejtorisë së Investimeve Kapitale më ka befasuar, kur ceku se nuk kanë paraparë asgjë deri më 2023. A nuk është anomali?!

Unë thash, si anëtar i komitetit, çka bëmë ne qe dy vjet?! Po ashtu, u cek nga parafolësit përtualete që askund nuk funksionojnë, kemi restorante për 100-200 vetë dhe nuk ka tualet për PAK!

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, theksoi se vullnetarisht po i caktojmë se në cilat drejtori po shkojmë, po ndahen nga dy vetë plus kryesuesja, dhe po i marrim përgjegjësitë tona si komitete dhe po i ndajmë cilën drejtori po e marrim. Sot po përcaktohem, po e shohim në PV çka ka Drejtoria e Sportit, ka me nda subvencionim 1000 euro në vit, por asnjeri prej anëtarëve nuk kemi projekte.

Jeton Canhasi tha ne nuk mundemi me bërë projekte, komiteti jo, janë kompanitë të cilat janë të regjistruara për me bërë projekte.

Premtime Preniqi theksoi se nuk është fjala për projekte të mëdha, por kur bën një aktivitet sportiv, ti e shkruan se KKPAK zhvilloi këtë aktivitet dhe aty faktikisht edhe shumë aktorë të tjera e kuptojnë që ekziston komiteti. D.m.th. është një fushatë lobuese edhe për komunitetin.

Nuk është fushatë ti me bërë pjerrina a diçka tjetër, por me ia dërguar drejtorisë kërkesat se ku po mungon, çka po mungon.

Ramadan Salihu u shpreh se projektin që e kemi fituar për shah prapë do të mbahet, por arsyja pse unë nuk kam riaplikuar është se salla dhe gjyqtarët na kanë ardhur falas, kështu që na kanë mbetur mjete nga ato të planifikuart. Për korrektësi, nuk kam dashur ato me i ndal përvete, por prapë do ta mbaj atë me mjetet që kanë mbetur. Kam raportuar me shkrim në Drejtorinë e Sportit për mbarëvajtjen e turnirit deri në mbarim. Do t'i raportoj edhe tani kur të mbahet turniri dhe besoj se do të jetë tradicional. Po ashtu, tha se duhet të bashkëpunojmë sa më shumë me OJQ-të, mos me parë njëri - tjetrin si rival.

Mehreme Llumnica pyeti se a mjaftojnë mjetet e mbetura për turnirin tjetër dhe a do të mbahet prapë në atë sallë, e cila nuk ka qasje për përdoruesit e karrocave.

Ramadan Salihu bëri të ditur se do t'i kërkoj "Hendikosit" që t'u sigurojë një sallë.

Premtime Preniqi theksoi se nëse ju konvenon kjo sallë këtu mund ta shfrytëzoni, se ka qasje edhe për përdorues të karrocave.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, propozoi që me riaplikuar prapë z. Ramadani, pastaj me pa si Komitet kemi kohë me bërë edhe ndonjë aktivitet tjetër shtesë, mundemi me mosha të mesme ose të vegjëlit.

Mehreme Llumnica shprehu mendimin se projektet kur të bëhen janë disa obligime, duhet me u raportuar shumë edhe duhet me qenë një konto ku qiten ato mjetet. Neve na pati ndihmuar drejtori Fitim Rexha, se e ke pasur shumë vështirë me i transferuar ato mjetet nëse nuk je OJQ, ne tani a mundemi me gjetur përkrahës të tillë.

Ramadan Salihu dha sqarime për këtë.

Mehreme Llumnica, sa i përket punësimit, tha se është shumë sensibilizuese nëse është një person, por ne si me mundur me i shty ata mekanizma stimulues për kompanitë e institucionet, ne është mirë me i shtyrë ata mekanizma, si p.sh. që ka bërë "Trafiku Urban" që ka shpallur konkurs enkas për PAK, kanë aplikuar PAK dhe janë zgjedhur më të mirët.

Jeton Canhasi pyeti se kush duhet me bërë takimin për Komunë, Komuna e ka, duhet, por po pyes për kompanitë private, ata që i kanë nga 200 punëtorë, kush e ka atë rol me i thënë ti zotëri i ke 200 të punësuar, a e dinë ti që me ligj duhesh me punësuar PAK.

Premtime Preniqi tha se këtë duhet ta bëjë Inspektorati i Ministrisë.

Mehreme Llumnica tha se te viti i PAK-së, ata për punësim kanë planifikuar, por është shumë e keqe, sepse Qeveria e kishte planin që OJQ-ja ose PAK me gjetur vet punën, kompaninë, pastaj ky me të stimuluar.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha se të vetmen zgjidhje e kam pa këtë mënyrë për me i angazhuar të gjithë anëtarët, përndryshe është edhe me pasur një përgjegjësi si anëtar i Komitetit me kontaktuar me dikë, me u treguar çka ka në PV që kjo drejtori duhet me realizuar, me u dërguar e-maillet etj.

Në bazë të diskutimeve, anëtarët e Komitetit i ndanë përgjegjësitë për zbatim dhe monitorim të Planit të veprimit.

Në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale - Mehreme Llumnica dhe Gyltene Retkoceri;

Në Drejtorinë e Shëndetësisë - Gyltene Retkoceri dhe Ermira Shabani;
Në Drejtorinë e Administratës dhe Financave - Ramadan Salihu dhe Armend Ademi;
Në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Drejtorinë e Bujqësisë - Ramadan Salihu dhe Mehreme Llumnica;
Në Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave - Jeton Canhasi dhe Mehreme Llumnica;
Në Drejtorinë e Arsimit - Ermira Shabani dhe Fatime Demolli;
Në Drejtorinë e Sportit dhe Kulturës - Jeton Canhasi dhe Armend Ademi;
Në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit - Mehreme Llumnica dhe Gyltene Retkoceri;
Në Ndërmarrja "Prishtina Parking" - Jeton Canhasi dhe Armend Ademi;
Njësia për të drejtat e njeriut - Pretime Preniqi;
Ndërmarrja Publike - Transporti Urban - Jeton Canhasi dhe Armend Ademi;
Ndërmarrja Publike Banesore - Armend Ademi dhe Jeton Canhasi.

Mehreme Llumnica, sa për informacion, tha se Drejtoria e Mirëqenies Sociale u ka ndarë të gjitha OJQ-ve grante, tash kanë me i monitoruar. E dyta, është koha e subvencionimit të anëtarëve me aftësi të kufizuara nga 120 euro një herë në vit. Ato ende nuk kanë filluar as me u vlerësuar asgjë, aty munden pak me u stimuluar diçka se e kanë qitur kriter vetëm Vendimi i pensionit të aftësisë së kufizuara vetëm të Mirëqenies.

Ramadan Salihu pyeti se a është hapur ende subvencionimi.

Mehreme Llumnica tha se ajo është e hapur çdo vit, prej muajit janar, mirëpo nuk po munden me u realizuar të gjitha kërkesat se po ka shumë aplikues e nuk ka buxhet.

Mbledhja përfundoi në orën 14:45.

Procesmbajtësja:
Shyhrete Islami

Kryesuesja e Komitetit
Fatime Demolli - Mustafa

